



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

10 Mars 2016

|



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË


www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Nefrologët në ditën botërore të veshkëve, sëmundjet e veshkëve të zbulohen që në lindje

Një e treta e fëmijëve të cilët paraqiten me shenja klinike të infeksionit të traktit urinar kanë ndonjë anomali të lindur në veshka dhe në traktin urinar...



Poashtu rreth 40 deri në 50 % e fëmijëve që janë në dijalizë kanë ndonjë anomali zhvillimore të veshkave dhe në traktin urinar, u tha në kuadër të shënimit të ditës botërore të veshkave, me moton “Fëmijët dhe sëmundjet e veshkëve – vepra në kohë që t'i ndalosh.

Velibor Tasiç, nefrolog nga Spitali për Sëmundje të Fëmijëve tha se sëmundjet e veshkave fillojnë qysh në mitrën e nënës. Ai tha se përveç peditrëve, edhe akusherët dhe gjinekologët kanë përgjegjësi të madhe sa i përket sigurimit të një shëndeti të mirë të veshkave.

“Është e një rëndësie të veçantë detektimi dhe parandalimi i hershëm i sëmundjeve të veshkëve. Në Maqedoni edhe më tej paraqesin problem anomalitë të lindura të veshkave dhe traktit urinar. Përqendrimi i kompetentëve duhet të jetë në diagnostifikimin dhe trajtimin e hershëm. Faktorët të cilët e përkeqësojnë gjendjen shëndetësore të të sëmurëve është obeziteti, pirja e duhanit në moshën adoleshente, gjë e cila injorohet. Nëna duhet të ushqehet shëndetshëm, të ketë nivelin e rregulluar të sheqerit në gjak të cilët janë faktorë të rëndësishëm për të pasur një fëmijë të shëndetshëm dhe veshkat të shëndetshme” – tha Velibor Tasiç, nefrolog nga Spitali për Sëmundje të Fëmijëve.

“Maqedonia si shtet ka mundësi të bëjë detektimin e hershëm të sëmundjeve të veshkave, madje edhe të foshnjës në mitrën e nënës për të shtuar se pikërisht nga këto arsye theksi këtë vit është vënë në parandalimin e sëmundjeve, para se ato të vijnë në stadin e shërimit”- tha Lubinko Trpenovski nga Shoqata “Nefron”.

Nefrologët bëjnë të ditur se Maqedonia ka një përqindje të lartë sa i përket transplantimit të veshkave që arrinë numrin prej 115 personash. (Vlora Latifi – Topojani, TVM2)



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Prezantim i rezultateve nga projekti i EPI-t për mbrojtje sociale



Instituti për politikë evropiane (EPI) – Shkup sot do ta mbanë ngjarjen përfundimtare nga projekti “(Pa)barazitë në mbrojtjen sociale” ku do të prezantohen rezultatet nga hulumtimi për pabarazitë intersekciste në mbrojtjen sociale në Maqedoni dhe Bosnjë e Hercegovinë.

Në ngjarjen do të marrin pjesë përfaqësues nga sektori qytetar, të cilët kanë punuar hulumtime në kuadër të Programit rajonal për promovimin e hulumtimeve, që hedhin dritë në aspekte të ndryshme të pabarazive në Maqedoni dhe në Evropën Juglindore.

Projekti është përkrahur nga programi rajonal për përkrahje të hulumtimeve në Ballkanin Perëndimor, ndërsa zbatohet në bashkëpunim me organizatën partnere Analitika-Qendër për hulumtime shoqërore nga Bosnja e Hercegovina.

Filloi funksionimi i sistemit për dhurim të veshjes



Prej sot ka filluar të funksionojë sistemi për dhurim të veshjes, i cili paraqet projekt të përpiluar nga ana e asociacionit “Ajde Makedonija” dhe SHMSH “Naum Ohridski” – Shkup. Qëllimet e tij janë për zvogëlimin e hedhjes së mbeturinave të tekstilit, ndihmës së personave me familje të rrezikuara sociale dhe mundësimi i personave me nevoja të veçanta të tregojnë se munden të ndihmojnë shumë në shoqëri.

Ky projekt do t’u mundësojë qytetarëve që teshtilin e vjetër, sidomos veshjen e vjetër ta sjellin në kontejnerë, i cili është vendosur para shkollës. Me këtë do të kontribuojnë drejt

mjedisit të shëndetshëm social, përmirësimin e mirëqenies së personave të rrezikuar sociale dhe të nxënësve me nevoja të veçanta, të cilat do të mund të tregojnë se guxojnë.

Aksioni realizohet si pjesë e programit të Civika mobilatis, i implementuar nga Qendra për arsimim evropian të Maqedonisë.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Alkooli në shtatzëni zvogëlon IQ-në e fëmijës?



Rezultatet e hulumtimeve të mëhershme për konsumimin e alkoolit gjatë shtatzënisë janë mjaft të pakompletuara. Disa rezultate kanë sugjeruar që konsumimi i moderuar i alkoolit nuk mund ta dëmtojë fëmijën, derisa disa kanë sugjeruar krejt të kundërtën.

Për ta hulumtuar edhe njëherë këtë tematikë, shkencëtarët nga Universiteti Oxford kanë testuar IQ-në (koeficientin e inteligjencës) te 400 fëmijë, transmeton Koha.net. Po ashtu kanë përcjellë frekuencën e konsumimit të alkoolit gjatë shtatzënisë së nënave të tyre.

Fëmijët e nënave, të cila kanë konsumuar alkool gjatë shtatzënisë, kanë pasur rezultate më të dobëta të testit të inteligjencës.

Efekti i alkoolit gjatë shtatzënisë

- Kur femrat shtatzënë konsumojnë alkool ai depërton në gjakun e saj, dhe këtë edhe në gjakun e fëmijës;
- Mëlçia e fëmijës nuk është e zhvilluar dhe nuk mund të shpërbëjë alkoolin siç mundet mëlçia e të rriturve;
- Bebja i nënshtrohet dukshëm më gjatë efektit të alkoolit në krahasim me nënën;
- Kur foshnja e palindur vazhdimisht i është ekspozuar alkoolit, mund të vjen deri te zhvillimi i sindromës alkoolike të fetusit (dëmtimi i sistemit qendror nervor, ndryshimet fizike, dëmtimet gjatë rritjes).

Shkencëtarët, hulumtimi i të cilëve është publikuar në revistën PLOS One, këshillojnë femrat shtatzëna që në tërësi të shmangin alkoolin, pse të rrezikojnë fare?

Gjatë shtatzënisë femrat nuk shqetësohen më vetëm për shëndetin e tyre, por edhe për shëndetin e fëmijës së vet. Edhe pse hulumtimi ka nevojë të vazhdohet, sepse shkencëtarët nuk kanë marrë parasysh edhe predispozitat gjenetike, shmangia e plotë e alkoolit gjatë shtatzënisë me siguri nuk do t'i bëjë keq fëmijës, ndërsa femrave shtatzënë do t'ua shkurtojë kënaqësinë, pa të cilën edhe ashtu munden.